



AGJENCIA E SHËRBIMEVE TË NAVIGACIONIT AJROR

RAPORT VJETOR 2021


Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror

Vrellë, Lypjan, 10070, Republika e Kosovës

Tel: +383 38 59 58 100

Email: info.ashna@rks-gov.net

Uebfaqe: www.ashna-ks.org





Mesazhi i Drejtorit

Të dashur miq dhe bashkëpunëtorë,

Kam kënaqësinë të ndaj me ju këtë raport pune të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror të Republikës së Kosovës, përmes të cilit kemi shpalosur informacione kyçe të cilat pasqyrojnë punën tone të përbashkët gjatë vitit 2021. Si pasojë e pandemisë Covid 19, e cila vazhdoj edhe gjatë vitit 2021, ASHNA u përball me vështirësi të theksuara në aktivitetet dhe projeksionet e saj zhvillimore.

Përkundër gjithë këtyre sfidave, ne arritëm që të ofrojmë shërbim të pandërprerë 24/7, gjithmonë duke ruajtur nivelet më të larta të sigurisë së operimeve dhe gjithashtu duke kushtuar vëmendje të vazhdueshme shëndetit dhe mirëqënies së personelit.


Duke vlerësuar maksimalisht përkushtimin e personelit në përmbushjen e misionit të ASHNA-së, më lejoni që të shprehë mirënjohjen dhe respektin për secilin, po ashtu edhe për instucionet tona vendore dhe partnerët tanë të çmuar.

Vlenë të theksohet se përkundër sfidave të lartëpërmendura, ASHNA me sukses të plotë ka përmbushur detyrat e saj në arritjen e objektivave kryesore të sigurisë dhe krahas kësaj ka zhvilluar dhe implementuar projeksione të rëndësishme strategjike në funksion të përmirësimit të infrastrukturës dhe kapaciteteve njerëzore. Në harmoni të plotë dhe të vazhdueshme me autoritet vendore dhe palë tjera të interesit, ne bashkërenduam veprimet për normalizim të plotë të hapësirës së ulët ajrore, si dhe dizajnuam plane përkatëse për menaxhim të hapësirës së lartë ajrore të Kosovës.

ASHNA mbetet e përkushtuar në përmbushjen dhe arritjen e detyrave dhe objektivave të saj, duke garantuar siguri dhe cilësi për gjithë shfrytëzuesit e hapësirës ajrore të Republikës së Kosovës.

Sinqerisht,

Samir Bllacaku
Drejtore



Përmbajtja

Mesazhi i Drejtorit.....	3
Profili i kompanisë.....	5
Historik.....	6
Aktivitetet Kryesore.....	8
Struktura Organizative.....	9
Bashkëpunimi Ndërkombëtar	10
Operimet dhe Infrastruktura	13
Përmirësimet operative.....	19
Koordinimi Civil-Ushtarak	20
Infrastruktura teknike.....	21
Sistemet e Menaxhimit të Sigurisë.....	30
Pasqyra e performansës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performansës	34
Performanca Financiare.....	46
Menaxhimi i Rreziqeve të Organizatës	67
Shërbime tjera.....	68
Burimet Njerëzore.....	69
Prioritetet për 2022	71

Profili i kompanisë

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror është organizatë buxhetore e themeluar si agjenci e pavarur me **Ligjin për Agjencinë e Shërbimit të Navigacionit Ajror 04/L-250** (publikuar në gazetën zyrtare nr.28, më 28.04.2014). Ligji ka filluar të implementohet më 01 janar 2016.

Me procesin e koncesionimit të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari” (prill 2011), shërbimet e navigacionit ajror mbetën jashtë projektit të koncesionimit, duke u organizuar dhe funksionuar për një periudhë kalimtare nën statusin e ndërmarrjes publike “ANP Adem Jashari” - Kontrolli Ajror.

ASHNA ofron shërbimet e navigacionit ajror të renditura në vijim, prej nivelit GND (tokë) deri në FL 205 (6250m) për të gjitha kategoritë e trafikut civil dhe ushtarak.

- **Shërbimet e Kontrollit të Trafikut Ajror**
- **Shërbimet e Informacioneve Aeronautike**
- **Shërbimet Meteorologjike dhe**
- **Komunikimi/ Navigimi/Vëzhgimi**

- ASHNA ka 173 të punësuar, kryesisht të shkolluar dhe përgaditur në insitute te specializuara europiane.

Historik

1999	Hapësira ajrore e Kosovës u mbyll për trafik civil		
2000	Fillojnë fluturimet komerciale në dy pika hyrëse/dalëse (SARAX dhe XAXAN) me Maqedoninë e Veriut	2016	• ASHNA themelohet si agjenci e pavarur me Ligjin për Agjencinë e Shërbimit të Navigacionit Ajror 04/L-250 • Certifikimi si ofrues i shërbimeve sipas legjislacionit në fuqi për Qiellin e vetëm Evropian
2001	Shkollimi i personelit operativ		
2004	• Licencimi i personelit • Ofrimi i shërbimeve nga personeli vendore	2017	Certifikimi si organizatë trajnuese
2011	Koncesionimi i aeroportit dhe ndarja e ofruesit të shërbimeve të navigacionit ajror nga aeroporti	2018	• ASHNA dhe KFOR nënshkruajnë procedurën e përbashkët operative • Anëtarësimi në CANSO • Nënshkruhet kontrata për projektin “Zgjatja e pistës, ngritjes së sistemit instrumental të aterrimit dhe sistemeve të radiokomunikimeve në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës Adem Jashari”
2013	Instalimi i radarit të ri SSR Mode S		
2014	Instalimi i sistemit të komunikimit VCSS dhe VCR	2020	LoA (Letter of Agreement) me ALBCONTROL për kordinimin e trafikut
2015	Transferimi në objektin e ri	2021	• Instalimi i sistemit ILS CAT III B • Instalimi i DVOR • Ricertifikimi si ofrues i shërbimeve të navigacionit ajror

Misioni

Normalizimi dhe ofrimi i sigurt i shërbimeve të navigimit ajror për shfrytëzuesit e hapësirës ajrore të Republikës së Kosovës.

Vizioni


ASHNA do të jetë konkurrese në ofrimin e shërbimeve të navigimit ajror me efikasitetin më të lartë të kostos në rajon

Në përputhmëshmëri të plotë me rregullativin e aplikueshëm vendor dhe ndërkombëtar, ASHNA synon ngritjen dhe modernizimin e kapaciteteve të saj, duke pasur qëllim gjithmonë arritjen dhe ruajtjen e nivelit më të lartë të sigurisë në ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror, normalizimin e hapësirës ajrore të Republikës së Kosovës, si dhe për të ndërtuar një ambient të besueshëm dhe tërheqës për klientët tanë.


Aktivitetet Kryesore

ASHNA është e çertifikuar sipas legjislacionit në fuqi për Qiellin e vetëm Evropian për shërbimet në vijim:

- ✓ Shërbimet e Trafikut Ajror
 - Kontrolli i Trafikut Ajror (ATC)
 - Shërbimi i Informacionit të Fluturimit (FIS)
 - Shërbimi Këshillues për Trafikun Ajror
 - Shërbimi i Alarmimit
- ✓ Shërbimet e Informacioneve Aeronautike
 - Publikimi i Informacionit Aeronautik (AIP)
 - Procesimi i NOTAM-ëve (NOF)
 - Shërbimi raportues Aeronautik (ARO)
- ✓ Shërbimet Meteorologjike
 - Parashikim
 - Vrojtim
- ✓ Komunikimi/ Navigimi/Vëzhgimi
 - Komunikim
 - Navigim
 - Survejim



Struktura Organizative



Bashkëpunimi Ndërkombëtar

Gjatë vitit 2021, ASHNA ka zhvilluar takime dhe komunikime pune me klientë, kryesisht operatorë ajror, ofrues të shërbimeve të navigacionit ajror, si dhe me individë dhe organizata ndërkombëtare, që kanë rol të rëndësishëm në fushën tonë të veprimit. Të gjitha këto takime dhe komunikime janë zhvilluar në funksion të përmirësimit dhe harmonizimit të bashkëpunimit, për arritjen e synimeve dhe planeve tona strategjike në zhvillimin e navigacionit ajror në Kosovë.

Në vijim kemi paraqitur statusin e bashkëpunimit me disa nga organizatat e ndërkombëtare, që kanë rëndësi të veçantë për ASHNA –në dhe më gjerë.



CANSO

ASHNA është anëtare në CANSO (Civil Air Navigation Services Organization).

CANSO është zëri global i industrisë së menaxhimit të trafikut ajror.

Si shoqatë e industrisë, bashkon ofruesit e shërbimeve të navigimit ajror në botë, novatorët kryesorë të industrisë dhe specialistët e menaxhimit të trafikut ajror, për të ndarë njohuritë, për të zhvilluar praktikën më të mira dhe për të formësuar të ardhmen për një hapësirë ajrore të sigurt dhe të integruar.



IATA (International Air Transport Association)



IATA është një shoqatë ndërkombëtare tregtare e linjave ajrore të botës.

Gjatë vitit 2021, ASHNA në kuadër të bashkëpunimit të vazhdueshëm me këtë organizatë ka zhvilluar një cikël trajnimesh, kryesisht të fokusuar në menaxhimin e shërbimeve të navigacionit ajror. Ne kemi projeksione në vazhdim që pritet të realizohen gjatë vitit 2022.

NATO

Që nga viti 1999 ASHNA (më herët si entitet tjetër) ka zhvilluar bashkëpunim të ngushtë dhe të shkëlqyeshëm me NATO, qoftë përmes komunikimeve të drejtëpërdrejta, apo përmes institucioneve shtetërore dhe KFOR-it. Sikur viteve të kaluara edhe gjatë vitit 2021 bashkëpunimi me NATO ka qenë i përqëndruar në çështjen e normalizimit të hapësirës ajrore të Kosovës dhe aspekteve tjera zhvillimore dhe të sigurisë në fushën e aviacionit.



Ky bashkëpunim kryesisht është organizuar dhe zhvilluar në kuadër të forumit BANM - "Balkans Aviation Normalization Meetings".

EUROCONTROL



Është organizatë europiane e sigurisë së navigacionit ajror. Meqenëse Kosova nuk është anëtare e kësaj organizate, bashkëpunimi ynë me këtë organizatë ka qenë relativisht i vështirë ndër vite. Ka pasur përpjekje të vazhdueshme për integrim të ASHNA-së në forume, rrjete dhe databaza të saj, të cilat janë kryesisht të nevojshme dhe në disa raste dhe të domosdoshme për menaxhim efikas dhe të sigurt të trafikut ajror. Vlerësojmë se na duhet mbështetje akoma më e theksuar insitucionale që të kemi çasjen e duhur në shfrytëzimin e informacioneve dhe platformave të Eurocontrolit. Gjatë vitit 2021, ne kemi adresuar disa shkresa, raporte përkatëse, si dhe kemi zhvilluar edhe takime me autoritetet vendore, me ç'rast edhe kemi ritheksuar nevojën dhe rëndësinë për tu integruar në këtë organizatë, apo edhe për të filluar procesin e aplikimit për anëtarësim.

Për arsye objektive, kryesisht kufizimeve nga pandemia, disa trajnime që kanë qenë të planifikuara të përcillen nga personeli ynë në insitucionin trajnues të Eurocontrol-it, nuk janë realizuar gjatë vitit 2021. Në planet për vitin 2022, kemi paraqitur edhe trajnimet që priten të zhvillohen përgjatë kësaj periudhe.

ASHNA gëzon bashkëpunim shumë të mirë me agjencitë fqinje dhe me akademi trajnuese europiane dhe globale. Në këtë aspekt, kemi zhvilluar aktivitete të vazhdueshme edhe gjatë vitit 2021, qoftë përmes takimeve apo komunikimeve tjera.

Operimet dhe Infrastruktura

Njësitë operative përbëhen nga:

- **Shërbimet e Trafikut Ajror**
 - Njësia Vajtje-Ardhje (Approach)



- Njësia e Kullës (Tower)



- **Shërbimet e Informatave Aeronautike**

- Publikimi i Informacionit Aeronautik (AIP)
- Procesimi i NOTAM-ëve (NOF)
- Shërbimi raportues Aeronautik (ARO)



- **Shërbimet Meteorologjike**

- Parashikim



- Vrojtım




- Komunikimi/Navigimi/Vëzhgimi
 - Komunikim
 - Navigim
 - Survejim



Rrjedha e trafikut


Edhe gjatë vitit 2021 janë ndjerë pasojat e pandemisë në planifikimet e trafikut. Në vijim janë paraqitur figurat e trafikut komercial dhe ushtarak për vitin 2021, krahasuar me vitet 2020 dhe 2019.



Krahasimi i numrit te operimeve komerciale 2020 - 2021

Operimet komerciale			Krahasimi me vitin paraprak	
Muaji/Viti	2020	2021	Nr. i operimeve	%
Janar	1369	1156	-213	-15.6%
Shkurt	1167	780	-387	-33.2%
Mars	641	841	200	31.2%
Prill	62	737	675	1088.7%
Maj	206	1149	943	457.8%
Qershor	156	1377	1221	782.7%
Korrik	903	2720	1817	201.2%
Gusht	1008	3026	2018	200.2%
Shtator	701	1660	959	136.8%
Tetor	1193	1598	405	33.9%
Nentor	794	1118	324	40.8%
Dhjetor	1094	1642	548	50.1%
TOTAL	9294	17804	8510	91.6%

Krahasimi i numrit te operimeve komerciale 2019 – 2021



Operimet komerciale			Krahasimi 2019-2021	
Muaji/Viti	2019	2021	Nr. i operimeve	%
Janar	1366	1156	-210	-15.37%
Shkurt	1086	780	-306	-28.18%
Mars	1257	841	-416	-33.09%
Prill	1420	737	-683	-48.10%
Maj	1556	1149	-407	-26.16%
Qershor	1599	1377	-222	-13.88%
Korrik	2170	2720	550	25.35%
Gusht	2309	3026	717	31.05%
Shtator	1549	1660	111	7.17%
Tetor	1321	1598	277	20.97%
Nentor	1198	1118	-80	-6.68%
Dhjetor	1367	1642	275	20.12%
TOTAL	18198	17804	-394	-2.17%


Operimet Ushtarake			Krahasimi	
Muaji/Viti	2020	2021	Operime	%
Janar	93	105	12	12.9%
Shkurt	68	107	39	57.4%
Mars	86	118	32	37.2%
Prill	171	126	-45	-26.3%
Maj	139	93	-46	-33.1%
Qershor	99	105	6	6.1%
Korrik	107	169	62	57.9%
Gusht	82	163	81	98.8%
Shtator	112	182	70	62.5%
Tetor	118	164	46	39.0%
Nentor	118	125	7	5.9%
Dhjetor	126	137	11	8.7%
TOTAL	1319	1594	275	20.8%

Operimet VFR			Krahasimi	
Muaji/Viti	2020	2021	Operime	Perqindja
Janar	98	144	46	46.9%
Shkurt	176	206	30	17.0%
Mars	160	187	27	16.9%
Prill	183	205	22	12.0%
Maj	141	266	125	88.7%
Qershor	248	288	40	16.1%
Korrik	257	239	-18	-7.0%
Gusht	206	286	80	38.8%
Shtator	190	223	33	17.4%
Tetor	305	142	-163	-53.4%
Nentor	147	207	60	40.8%
Dhjetor	99	185	86	86.9%
TOTAL	2210	2578	368	16.7%

Përmirësimet operative

Gjatë vitit 2021, ASHNA zbatoi projektin e ndryshimeve në hapësirën ajrore, për të mundësuar një përgjigje në kohë ndaj trendit të pritshëm të rritjes së trafikut, për t'u ofruar përdoruesve të hapësirës ajrore shërbim më të mir dhe për të akomoduar kërkesat e normalizimit të hapësirës ajrore.

Në këtë kontekst janë dizajnuar dhe implementuar procedurat e reja instrumentale për vajtje dhe ardhje (SID/STAR)



Koordinimi Civil-Ushtarak

ASHNA është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror edhe për trafikun ushtarak. Këto detyra zhvillohen në koordinim të ngushtë dhe të përhershëm me KFOR-in dhe autoritetet vendore. Në funksion të ruajtjes së sigurisë dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve, gjatë vitit 2021 janë zhvilluar takime të rregullta dhe janë shkëmbyer të dhëna të rëndësishme mes palëve.



Infrastruktura teknike



Sistemi i monitorimit të sistemeve të kullës

Ky sistem është instaluar gjatë vitit 2021. Sistemi mundëson integrimin e të gjithë monitorëve në një sistem të vetëm, modern dhe të adaptueshem.

Sistemet që monitorohen nga departamenti teknik janë:

- Sistemi i survejimit primar dhe sekondarë me lokacione në ASHNA dhe Golesh,
- Sistemi i radiokomunikimeve,
- Sistemi VCSS,
- Sistemi ATIS,
- Sistemi AWOS,
- Sistemi ATM,
- Sistemi ILS dhe DVOR,
- Sistemi HVAC dhe GEN,
- Sistemi telefonik, etj.

Sistemi i integruar i monitorimit mundëson zgjidhje homogjene dhe të integruar për monitorim, kontroll, prezantim dhe menaxhim të shërbimeve të ofruara.

Furnizimi me “Real time surveillance analysis software”

Gjatë vitit 2021 është nënshkruar kontrata “Supply of a real time surveillance analysis software”. Ky sistem mundëson verifikimin e saktësisë së sistemeve të survejimit dhe është një alternativë e sistemit “SASS-C tool” (Surveillance Analysis Support System for ATC Centres) që është produkt i Eurocontrolit. Sistemi në kohë reale verifikon dhe analizon të dhënat e sistemeve të survejimit dhe gjeneron raportet përkatëse.

ILS-Instrument Landing System

LLZ-Localizer and GP-Glide Path



Gjatë vitit 2021 në ASHNA janë instaluar dy sisteme të ILS-it nga prodhuesi INTELCAN. Sistemi shërben për aterrim në kushte meteorologjike për CATIII B nga njëra anë e pistës dhe CAT I nga ana tjetër.

ILS-i është sistem i cili shërben për aterrim instrumental të fluturakeve. Quhet sistem meqenëse përbehet nga pajisjet Localizeri, Glide Path-i dhe në shumicën e rasteve DME. Për të qenë i kompletuar dhe funksional të 3 pajisjet duhet të jenë në rregull dhe funksionale.

Një fluturake që i afrohet pistës për aterrim udhëhiqet nga pranuesi i ILS në fluturake duke demoduluar dhe llogaritur sinjalet e pranuar nga ILS.

Lokalizeri ofron udhëheqje laterale, Glide Path ofron udhëheqje vertikale ndërsa DME tregon distancën deri në pikën e aterimit.

Sistemet janë instaluar me projektin “Zgjatja e pistës, ngritjes së sistemit instrumental të aterimit dhe sistemeve të radiokomunikimeve në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës Adem Jashari”.

DME-Distance Measuring Equipment

Me projektin “Zgjatja e pistës, ngritjes së sistemit instrumental të aterimit dhe sistemeve të radiokominikimeve në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës Adem Jashari” është instaluar edhe sistemi DME.

Në ASHNA kemi tri DME. Njëra e kolokuar me DVOR kurse dy të tjerat të kolokuara me ILS. Dy DME-të e kolokuara me ILS janë INTELSCAN, me fuqi 100W, kurse DME e kolokuar me DVOR është SELEX me fuqi 1kW. Në të dy rastet qëllimi dhe funksioni i DME është i njëjtë. Sipas fuqisë DME-të ndahen në En route dhe terminal. En-Route DME’s përdoren për distanca të largëta dhe përdoren si pikë rrugë përgjatë rrugëve ajrore. Janë zakonisht 1kW. Terminal DME gjenden në aeroporte (100W).

Frekuenca e DME mvaret se a është e kolokuar me DVOR apo me ILS dhe janë të parapara me rekomandimet e ICAO.

Rilokimi i DVOR-it ekzistues

Rilokimi i sistemit të DVOR-it është realizuar në kuadër të projektit të “Zgjatjes së pistes”. Sistemi DVOR është prodhim i SELEX USA. Në radio navigim DVOR-i është një transmetues i cili i mundëson fluturakes të llogarisë drejtimin tek apo nga transmetuesi.

Rilokimi i sistemit është kryer më herët, por gjatë vitit 2021 janë kryer testimet nga ajri dhe sistemi është lëshuar në operim. Procedurat e reja STAR dhe SID janë të bazuara në këtë DVOR. Jetëgjatësia e këtij DVOR-i mbetet shqetësuese, meqenëse është blerë në vitin 2011.

Kjo paisje ishte pjesë e kontratës së dështuar për “Furnizim me Sistemet e Navigimit dhe Rilokim i Sistemeve Ekzistuese” dhe nuk ka qenë në shërbim gjatë këtyre viteve.

Pas zhvendosjes/ rilokimit të DVOR-it, kemi humbur mbulueshmërinë në pjesën përfundimtare, përkatësisht mbulueshmërinë e koridoreve ajrore me Malin e Zi.

Sistemi i Radiokomunikimit



Në kuadër të projektit zgjatja e pistës, kanë qenë të përfshira edhe projektet:

- Sistemi i radiokomunikimit në Golesh dhe ASHNA
- Sistemi VCSS SITTI
- Sistemi për rekordimin e zërit
- “Upgrade i sistemit ekzistues të VCSS Garex
- RRC-Radio Remote Controller –Backup Radio

Sistemi i radiove dhe ai i rekordimit të zërit janë prodhim i kompanisë norvegjeze JOTRON. Sistemi primar VCSS është prodhuar nga SITTI-Itali, kurse ai dytësor nga INDRA(Garex).

Të gjitha këto sisteme janë finalizuar dhe komisionuar në Shkurt/Mars 2022. Vlen të ceket se në sistemin e ri të radiokomunikimit janë të instaluar frekuencat e reja, të cilat janë caktuar nga autoritetet ndërkombetare.

Secila frekuencë operative, përpos që përbëhet prej një çifti të radiove Main dhe STBY, kanë edhe mbulueshmëri të dyfishtë nga dy lokacionet me sinjal të radiokomunikimit.

Frekuncat e GND dhe TWR janë prezente në dy lokacione Golesh dhe ASHNA, poashtu frekuencat e “UPPER Airspace” janë prezente në dy lokacione, kurse frekuencat e APP janë prezent vetëm në një lokacion (Golesh) dhe për shkak të relievit nuk mund të instalohen në ASHNA, pasi që nuk do të ketë mbulueshmëri të dyfishtë në anën perendimore. Për këtë

arsye, me projektin e Gërmisë edhe këto frekuenca të APP do të kenë mbulueshmeri të dyfishtë, projekt që pritet të finalizohet gjatë vitit 2022.

Të gjitha këto frekuenca integrohen në dy sisteme të VCSS, nga ku kontrollorët e trafikut ajror mund të pranojnë dhe transmetojnë mesazhet koordinuese për hapësirat përkatëse ajrore.

Vlen të ceket se të gjitha këto koordinime në mes kontrollorëve të trafikut ajror dhe pilotëve, dhe komunikimet tokësore me organizatat simotra, janë të integruara në sistemin për incizim të zërit, i cili poashtu është finalizuar dhe komisionuar.

Në kuader të këtij projekti janë instaluar edhe “backup” radiot, në Golesh dhe ASHNA, ku përmes një “display”, kontrollorët mund të qasen këtyre radiove për komunikim në rast se sistemi primar mund të dështoj për qfarëdo arsye. Këto radio janë “multichannel”, pra mund të integrohet qfarëdo frekuence nga operatorët-Kontrollorët e trafikut ajror.

Projekti i MSSR Mode S

Gjatë vitit 2021 është instaluar edhe sistemi i ri MSSR Mode S me lokacion në Aeroportin e Gjakovës.

Ky projekt është ndërprerë përkohësisht për shkak të pandemisë. Këtë vit kanë rifilluar dhe përfunduar punimet. Është rifilluar me pjesën e instalimit të shtyllës dhe pjesës dytësore të projektit (auxillary). Ka përfunduar edhe instalimi i pjesës elektronike të sistemit RADAR-ik. Kjo pjesë e punës ka përfunduar në maj. Paralelisht me këtë, ka qenë në proces e sipër edhe instalimi i linjave të komunikimit primarë dhe sekondarë. Linja primare është instaluar nga PTK, ndërsa për sekondarja është kontraktuar nga IPKO.

Pas ardhjes së ekipit të Leonardos, ka përfunduar instalimi i MSSR Mode S. Poashtu ka përfunduar edhe konfigurimi i tij dhe i ashtuquajturit “fine tuning”. Është përfunduar trajnimi i stafit në lokacion dhe pranimit teknik. Mbetet për tu realizuar kalibrimi nga ajri, integrimi në ATM dhe pranim dorëzimi.



Rilokimi dhe azhurimi i APP/TWR”

Pas dështimit të kontratës për rilokimin e paisjeve RADAR dhe DVOR nga kontraktori TCN (vlera e kontratës 7.8 milion), ASHNA ka kontraktuar prodhuesin Leonardo për rilokim dhe finalizimin e këtij projekti.

Projekti “Rilokimi dhe azhurimi i APP/ TWR “ ka mundësuar rilokimin dhe azhurimin e serverëve të sistemit ekzistues në lokacionin e ri. Meqenëse bëhej fjalë për sistemin që ishte në funksion, të gjitha kërkesat e sigurisë që kanë rrjedhë nga vlerësimet e sigurisë janë marrë parasysh.

Projekti poashtu ka përfshirë mundësinë e vizualizimit të të dhënave të Modit S dhe trajnimin e stafit operacional për shfrytëzimin e sistemit të ri.

Sistemi AWOS CATIIB (Main dhe Backup), ATIS, VOLMET dhe Sistemi për Parashikim

Në kuadër të projektit zgjatja e pistës, kanë qenë të përfshira edhe projektet:

- Sistemi i AWOS Main dhe Backup
- Sistemi ATIS dhe VOLMET
- Sistemi për parashikim të motit

Sistemet janë prodhim i kompanisë amerikane DTN. Përbëhen nga sensorët të cilat janë instaluar përgjatë pistës, serverët për përpunimin e të dhënave dhe pozicionet e punës që gjenden tek meteorologët dhe kontrolla e trafikut ajror.

Sistemi është i integruar me sistemet ATIS dhe VOLMET që së bashku e përbëjnë një sistem. Sistemi AWOS CATIIB do të jetë pjesë përbërëse e sistemeve që do të na mundësoi ofrimin e shërbimeve CATIIB në ASHNA.



Sistemet e Menaxhimit të Sigurisë

Menaxhimi i Sigurisë

Siguria, apo niveli i lartë i sigurisë në ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror, i ofruar nga ASHNA, ka prioritet mbi aspektin tregtar, operacional, social dhe çdo aspekt tjetër të biznesit. Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë (SMS) i ASHNA-së synon arritjen sistematike dhe proaktive të një niveli të pranueshëm sigurie, duke dhënë kështu një kontribut të çmuar drejt sigurisë së trafikut ajror evropian në përgjithësi.



Komponenti kryesor i SMS-it është Manuali i Menaxhimit të Sigurisë, i cili përcakton organizimin dhe proceset e SMS-it, si dhe procedurat bazë të SMS-it, në mënyrë që të përputhet me kërkesat e SMS-it të përcaktuara në rregulloret kombëtare dhe standardet evropiane të sigurisë.

Matja e performancës së sigurisë dhe Monitorimi i vazhdueshëm i performancës së sigurisë, na ndihmon të përmirësojmë nivelin e sigurisë dhe shërbimet tona në përgjithësi. Fushat kryesore të performancës së sigurisë së ASHNA-së janë në përputhje me rregulloret e zbatueshme të AACK-së.



“Just Culture”

Çelësi për zbatimin e suksesshëm të rregulloreve të sigurisë është të arrihet një mjedis raportimi "JUST CULTURE" brenda organizatave të aviacionit, rregullatorëve dhe autoriteteve të hetimit. Kjo kulturë efektive e raportimit varet nga mënyra se si organizata trajton fajin dhe ndëshkimin.

Koncepti “JC” ka për qëllim që të zhvillohet një kulturë në të cilën operatorët e linjës së parë dhe të tjerët nuk ndëshkohen për veprime, mosveprime ose vendime që kanë marrë dhe që janë në përpjesëtim me përvojën e tyre dhe trajnimin, ndërkohë që neglizhenca e rëndë, shkeljet e qëllimshme dhe aktet shkatërruese nuk tolerohen.

Në vazhden e ngritjes së kësaj kulture, gjithnjë në interes të ngritjes së nivelit të sigurisë dhe adaptimit të rregulloreve të BE-së, ASHNA ka implementuar “JUST CULTURE” si pjesë e Menaxhimit të Sigurisë.

Menaxhimi i Cilësisë

ASHNA ka implementuar Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë (SMC) dhe është në proces për t’u certifikuar në përputhje me kërkesat e standardit ndërkombëtar ISO 9001:2015.

ISO 9001:2015 SMC ndihmon në përmirësimin e performancës së përgjithshme dhe ofron një bazë solide për zhvillim të qëndrueshëm.

Cilësia e shërbimeve tona garantohet nëpërmjet SMC-së së integruar, e cila rishikohet dhe vlerësohet periodikisht për përshtatshmërinë, efektivitetin dhe efikasitetin e saj afatgjatë.

Konsultimi me Shfrytëzuesit e Shërbimeve dhe Matja e Kënaqshmërisë

Duke u bazuar në Nenin 16, Paragrafi 1.12 i Ligjit Nr. 04/L 250 për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, si të Rregullores Nr. 7/2012 të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës mbi Kushtet për Ofrimin e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, është zhvilluar një takim konsultativ me shfrytëzuesit e shërbimeve tona. Ky takim zhvillohet në funksion të ngritjes së cilësisë së shërbimeve tona, duke ndarë me shfrytëzuesit e shërbimeve informacione për planet zhvillimore të ASHNAs dhe për adresimin e çdo çështjeje me interes.



Po ashtu, në mbështetje të nenit 16, përkatësisht pikës 1.8, 1.12 dhe 1.13 të Ligjit për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA), kemi zhvilluar një anketim për matjen e Kënaqshmërisë së Konsumatorit me Shërbimet e ASHNA-së për vitin 2021. Nga ky anketim rezulton se shfrytëzuesit e shërbimeve janë shumë të kënaqur me shërbimet e ASHNA-së.

Menaxhimi i Sigurimit


Sistemi i Menaxhimit të Sigurimit në ASHNA (SecMS) garanton sigurinë e punonjësve dhe personave të tjerë në ambientet tona, sigurinë e objekteve, pajisjeve teknike dhe pajisjeve, për të parandaluar ndërhyrjet e paligjshme në ofrimin e shërbimit. ASHNA gjithashtu mbron të dhënat e biznesit të cilat i merr, prodhon ose përdor në çfarëdo mënyre tjetër duke ju dhënë qasje në të dhënat në dispozicion, personave dhe institucioneve të autorizuar. SecMS rregullohet nga Programi Kombëtar i Sigurisë së Aviacionit Civil për Republikën e Kosovës. Synimi i Sistemit është parandalimi dhe veprimi në përputhje me Politikën e Sigurimit, ku masat e prezantuara nuk duhet të ngadalësojnë ose pengojnë në ndonjë mënyrë tjetër proceset tona kryesore të biznesit.




Pasqyra e performansës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performansës

Raportimi i Hazardeve



Hazardet e raportuara 2021					
Muaji/Dep	DATS	DTEK	DMET	DAIS	TOTAL/MONTH
Janar	12	3	1	0	16
Shkurt	21	10	0	0	31
Mars	39	9	3	0	51
Prill	4	6	0	0	10
Maj	25	20	0	0	45
Qërshor	17	19	0	0	36
Korrik	17	5	1	0	23
Gusht	28	4	4	0	36
Shtator	37	13	0	0	50
Tetor	44	16	6	0	66
Nëntor	12	5	5	0	22
Dhjetor	19	10	2	0	31
TOTALI	275	120	22	0	471






Në departamentin e DCSS janë regjistruar:

- **Ndodhi të kategorisë A (aksidente) – 0**
- **Ndodhi të kategorisë B (incidente) – 6**
- **Ndodhi të kategorisë B (zvogëlim i ndarjes) – 0**
- **Ndodhi të kategorisë C – 103**
 - ✓ Incidentet me ndikim të Menaxhimit të trafikut ajror (ATM) – 0
 - ✓ Dështimi i funksionit të Komunikimit – 32
 - ✓ Dështimi i funksionit të Navigimit – 8
 - ✓ Dështimi i funksionit të Survejimit – 19
 - ✓ Dështimi i funksionit ndihmës të informimit – 17
 - ✓ Dështimi i funksioneve të procesimit të të dhënave – 20
 - ✓ Të tjera – 7
- **Ndodhi të kategorisë D – 60**



Krahasueshmëria 2016 – 2017 – 2018 – 2019 – 2020 – 2021



Aneks 01 - Caqet dhe treguesit kyç të performansës së Sigurisë për vitin 2021

Nr	TKP (SPI) për procese	Totali i ndodhive në vitin 2021	Totali i ndodhive në vitin 2020	Treguesi i sigurisë	Masat e parapara	Caqet e performansës së sigurisë për vitin 2021
1	Incidentet me ndikim të Menaxhimit të trafikut ajror (ATM)	6	0	Numri i incidenteve me ndikim të Menaxhimit të Trafikut Ajror (ATM)	Të vetëdijesohet stafi që në mënyrë proaktive të identifikojë hazardet që mund të shpijnë drejt cenimit të sigurisë.	Numri i incidenteve me ndikim në ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 10 incidente në vit
2	Dështimi i funksionit të Komunikimit	32	19	Numri i dështimeve të funksionit të Komunikimit me ndikim të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të zvogëlohet	Janë planifikuar prokurimi i sistemit të ri të radiove nga ASHNA, si dhe radio të reja janë përfshi në projektin për zgjatjen e pistës (Kontrata mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe LKIA për "Zgjatjen e pistës, ngritjes së sistemit instrumental të aterrimin dhe sistemeve të radiokomunikimeve në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës Adem Jashari" nr. Identifikues MI-7-024-5.1.5 dhe nr. të kontratës 023/2017 të datës 09.08.2017)	Numri i ndodhive të dështimit të funksionit të Komunikimit me ndikim në ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 15 dështime në vitin 2021

3	Dështimi i funksionit të Navigimit	8	4	Numri i dështimeve të funksionit të Navigimit me ndikim të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të zvogëlohet	Janë planifikuar sistemet e reja të navigimit në projektin për zgjatjen e pistës (Kontrata mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe LKIA për “Zgjatjen e pistës, ngritjes së sistemit instrumental të aterritimit dhe sistemeve të radiokomunikimeve në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës Adem Jashari” nr. Identifikues MI-7-024-5.1.5 dhe nr. të kontratës 023/2017 të datës 09.08.2017)	Numri i ndodhive të dështimit të funksionit të Navigimit me ndikim në ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 5 dështime në vitin 2021.
4	Dështimi i funksionit të Survejimit	19	7	Numri i dështimeve të funksionit të Navigimit me ndikim të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të zvogëlohet	Është planifikuar prokurimi i sistemit të ri të survejimi si dhe jemi në proces të rregullimit dhe azhurimit të sistemit ekzistues PSR/MSSR.	Numri i ndodhive të dështimit të funksionit të Survejimit me ndikim në ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 5 dështime apo 94 orë në vitin 2021, përfshi këtu edhe ndërprerjet për mirëmbajtje të planifikuar
5	Dështimi i funksionit ndihmës të informimit	17	13	Numri i dështimeve të funksionit Ndihmës të informimit duhet të zvogëlohet	Janë planifikuar sistemet e reja dhe azhurimi i atyre ekzistuese në projektin për zgjatjen e pistës (Kontrata mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe LKIA për “Zgjatjen e pistës, ngritjes së sistemit instrumental të aterritimit dhe	Numri i ndodhive të dështimit të funksionit të funksionit ndihmes të informimit me ndikim në ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 25 dështime në vitin 2021

					sistemeve të radiokomunikimeve në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës Adem Jashari” nr. Identifikues MI-7-024-5.1.5 dhe nr. të kontratës 023/2017 të datës 09.08.2017)	
6	Dështimi i funksioneve të procesimit të të dhënave	20	9	Numri i dështimeve të funksionit procesimit të të dhënave duhet të zvogëlohet	Është planifikuar duplikimi i sistemit AFTN si projekt kapital për vitin 2019. Në këtë projekt janë të përfshira edhe trajnimet nga prodhuesi për intervenime të nivelit të dytë	Numri i ndodhive të dështimit të funksionit të Procesimit të të dhënave me ndikim në ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 7 dështime në vitin 2021
7	Të tjera	7	6	Numri i dështimeve tjera duhet të zvogëlohet	Janë planifikuar trajnime të ndryshme profesionale dhe nga aspekti i sigurisë me të cilat parashihet mes tjerash edhe ndërgjegjësim i personelit në raport me përgjegjësitë e tyre që ndërlidhen me siguri.	Numri i ndodhive të dështimit të funksioneve tjera me ndikim në ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 10 në vitin 2021.
Totali		109	58			

Arsyeshmëria për rritjen e ndodhive të raportuara

Nga tabela e caqeve dhe treguesve kyç të performancës së sigurisë për vitin 2021 (aneksi 01 i këtijë raporti), vërehet se në kategorinë C ka rritje në numrin total të raportimeve në krahasim me vitet paraprake apo i kanë tejkaluar caqet e planifikuara mirëpo ka rënie në krahasim me vitet paraprake në kategorinë D të raportimeve.

Në fushën e funksionit të komunikimit, ka rritje nga vitet paraprake dhe është tejkaluar caku i performancës së përcaktuar.

Në fushën e funksionit të navigimit, ka rritje në krahasim me vitet paraprake dhe është tejkaluar caku i performancës së përcaktuar.

Në fushën e funksionit të survejimit, ka rritje në krahasim me vitet paraprake dhe është tejkaluar caku i performansës së përcaktuar.

Në fushën e funksionit ndihmës të informimit, ka rritje në krahasim me vitin e kaluar, mirëpo nuk është tejkaluar caku i performansës së përcaktuar.

Në fushën e funksionit të procesimit të të dhënave, ka rritje në krahasim me vitet paraprake dhe është tejkaluar caku i performansës së përcaktuar.

Nodhitë në këtë fushë, kryesisht kanë të bëjnë me problemet e shkaktuara në sistemin ATM, ku për shkaqe të ndryshme kanë ndodhur restartime të pozitive operuese duke shkaktuar humbje të fotografisë së radarit si dhe humbje dhe devijime të objekteve në radar (radar targets). Në lidhje me këtë çështje, DCSS së bashku me DATS, kanë realizuar një vlerësim të sigurt për t'u siguruar që performanca e sigurtisë së operimeve, në ASHNA nuk do të ndikohet gjatë ofrimit të shërbimeve radarike.

Duhet theksuar se gati se të gjitha ndodhitë janë krejtësisht si pasojë e vjetërsisë së pajisjeve, të cilat janë planifikuar të modernizohen me sistemet e reja dhe azhurimin e atyre ekzistuese në projektin për zgjatjen e pistës (Kontrata mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe LKIA për "Zgjatjen e pistës, ngritjes së sistemit instrumental të aterritimit dhe sistemeve të radiokomunikimeve në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës Adem Jashari" nr. Identifikues MI-17-024-5.1.5 dhe nr. të kontratës 023/2017 të datës 09.08.2017).

Vlen të theksohet se edhe ngritja e nivelit të vetëdijësimit të personelit për raportime, duke pasur parasysh angazhimin e menaxhmentit në fuqizimin e "No Blame Policy" dhe prezentimin e "Just Culture", ka ndikuar në rritjen e raportimeve, gjithmonë në funksion të identifikimit dhe përmirësimit të zbrastësirave të mundshme, si dhe ngritjes së kapaciteteve, me qëllim të ngritjes së nivelit të përgjithshëm të sigurtisë.

MONITORIMI PERFORMANCËS

Të gjithë objektivat e indikatorëve kyç të performancës (KPI) të përcaktuara në planin e performancës për vitin 2021 janë përmbushur dhe tendencat në treguesit e performancës që po monitorohen janë pozitive.

FUSHA E PERFORMANCËS SË SIGURISË						
Safety KPI #1: Niveli i Efikasitetit të Menaxhimit të Sigurisë						
		2020 Caku	2020 Vlera aktuale	2021 Caku	2021 Vlera aktuale	2022 Caku
Objektivat fillestare të performancës	ASHNA (Objektivat e menaxhmentit për kulturën e sigurisë	B	C (50)	B	C (50)	C
	ASHNA (për të gjitha objektivat tjera të menaxhmentit)	C	C (55.2)	D	C (55.2)	D
	Përputhja me caqet në nivel të BE-së	Sipas AAC: ASHNA pritet që deri në vitin 2021, të arrijë caqet e përcaktuara në nivel të BE-së, ndërsa ka arritur caqet e vendosura në nivel shteti për vitet 2019 dhe 2020. ASHNA ka treguar përparim të dukshëm, sidomos në objektivat që ndërlidhen me Kulturën e Sigurisë. Përparim ka treguar edhe në objektivat tjera të menaxhmentit duke e ngritur nivelin e efikasitetit nga 48.1 në 55.2.				

Safety KPI #2: Aplikimi i shkallës së klasifikimit bazuar në metodologjinë (RAT) Risk Analyses Tool						
